



Asociacioni i Komunave të Kosovës

R A P O R T

nga

Takimi i Kryesisë të Kolegjiut për Arsim dhe Kulturë

Prishtinë, 24 gusht 2011

HYRJE

Asociacioni Komunave të Kosovës (AKK), në bazë të vendimit të Kolegjiut për Arsim dhe Kulturë të marrë në takimin e fundit të mbajtur me 8 korrik 2011, organizoj takimin e Kryesisë me 24 gusht 2011 (e mërkurë) me fillim nga ora 13:00 në zyre te AKK-së në Prishtinë, me qëllim rishikimin e draft ligjit të fundit të për arsimin para universitar dhe të përcjell vërejtjet/komentet përfundimtare Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport në Kuvendin e Kosovës..

Në takim morën pjesë:

- Azem Guri – Kryesues,
- Qerim Selimi – zv. kryesues
- Jashar Lushtaku – anëtar
- Nexhmi Rudari – anëtar
- Ertan Munoglu – Menaxher Programi, AKK
- Fisnik Dashi – Koordinator i Kolegjiut, AKK

Në takim munguan anëtarët e Kryesisë znj. Fahrije Kryeziu nga Komuna e Kamenicës dhe Verica Ristic respektivisht nga Komuna e Gracanicës.

PËRMBLEDHJE

Sipas informatave të pranishmeve, draft ligji për arsimin para universitar është finalizuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe është proceduar në Komisionin për Arsim Kulturë Rini dhe Sport të Kuvendit të Kosovës për leximin final.

Duke marrë parasysh se draftligji do të procedohet për aprovim në Kuvendin e Kosovës me 29 gusht 2011, Kryesia me këtë rast organizoj takimin për shqyrtimin përfundimtar të këtij drafti dhe paraqitjen përmes kërkesës zyrtare në bashkëpunim me Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK) për rekomandimet/kërkesat e Kolegjiutit për Arsim dhe Kulturë në mbrojtje të interesave të drejtorive komunale për arsim dhe kulturë.

Përveç kësaj, të pranishmit kanë filluar debatin për këtë draftligj duke potencuar vërejtjet dhe rekomandimet në pikat në vijim:

Neni 8 – Inspektimi i arsimit – Në kuadër të inspektimit të arsimit duhet të përfshihet edhe inspektimi gjatë procesit mësimor, gjegjësisht të inspektohet mënyra e mësimdhënies.

Neni 9.6 – Vendimi për regjistrimin e nxënësve të ri në shkolla fillore duhet të merret nga Drejtoria Komunale për Arsim (DKA), sepse disa shkolla nuk kanë shërbime profesionale pedagogjike dhe psikologjike për të kryer procesin e regjistrimit në mënyrë të duhur.

Neni 11.8 – Tekstet shkollore për lëndë obligative duhet të miratohen nga Ministria, ndërsa tekstet për lëndë zgjedhore duhet të mbeten në kompetencë të shkollës për shkak të specifikave të tyre të veçanta.

Neni 17 – AKK propozon që Drejtori i shkollës duhet patjetër që në afat prej 3 muajve të formoj Këshillin Drejtues (KD) të shkollës. Përndryshe Kryetari i Komunës do të shkarkon Drejtorin e shkollës.

Neni 17.2.2 – Duhet specifikuar që palët e interesuara duhet të emërohen nga DKA. Nëse mbetet e përgjithshme që Komuna të bëjë emërimin, pastaj do të ketë paqartësi se kush në komunë duhet bërë këtë emërim.

Neni 17.9 – Meqë nuk ka Zëvendës Drejtor të DKA-së, KD i shkollës mund të ftoj Drejtorin e DKA-së, i cili mund të caktoj përfaqësuesin e vet për KD.

Neni 21.1 – Duhet specifikuar që Zyrtari administrativ dhe financiar duhet të emërohet nga DKA. Nëse mbetet e përgjithshme që Komuna të bëjë emërimin, pastaj do të ketë paqartësi se kush në komunë duhet bërë këtë emërim.

Neni 22.1 – Kuvendi Komunal është përgjegjës për miratimin e rregulloreve të përgjithshme që kanë të bëjnë me të gjitha shkollat në menaxhim të komunës, ndërsa shkollat duhet të kenë autonominë për të përgatitur dhe miratuar rregulloret e tyre të brendshme.

Neni 31.1 – Meqë mësimitdhënësit nuk janë shërbyes civil, duhet sqaruar mirë cili ligj aplikohet për mësimitdhënësit - ligji i punës apo ai për shërbyesit civil?

Neni 35.4 – Përzgjedhja e mësimitdhënësve dhe personelit teknik në institucione shkollore duhet bërë nga një Komision i cili themelohet nga DKA, ku Drejtori i institucionit shkollore do të jetë kryetarë i Komisionit.

Neni 35.6 – Kontrata e mësimitdhënësit të pakualifikuar për drejtimin përkatës që punësohet në fillim të vitit shkollore duhet të zgjasë deri në përfundim të vitit shkollore, pra deri në fund të gushtit. Kjo për arsye se duhet siguruar që mësimitdhënësi në fjalë të jetë i punësuar edhe gjatë afateve të korrikut dhe gushtit për nxënësit më të dobët. Kontrata tjera duhet të jenë me akte emërimi.

Neni 38 – Ky nen duhet të precizoj se cilat janë mënyrat e pagesës së punëtorëve të përkohshëm- a paguhen me kontratë mbi vepër apo në ndonjë mënyrë tjetër?